



REPUBLIKA E SHOIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

BULETINI ZYRTAR

NR.5, 2009

TIRANË 2009



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS**

BULETINI ZYRTAR

NR.5, 2009

TIRANË, 2009



Botuar nga: Autoriteti i Konkurrencës

Përpunimi grafik: Erald Lamja

Shtypur nga: Shtypshkronja 'Kumi'

© Autoriteti i Konkurrencës, Tiranë, 2009

Përmbajtja

- Fq.5 Vendimi nr. 100, datë 03.02.2009 Mbi hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine MAK Shpk nga shoqëria Advanced Construction Group shpk
- Fq.7 Vendimi nr.101, datë 05.02.2009 “Për një shtesë në Vendimin Nr. 88 datë 02. 10. 2008 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit”
- Fq.9 Vendimi nr.102, datë 17.02.2009 Për rekomandime ndaj Projekt - Ligjit “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”
- Fq.11 Vendimi nr.103, datë 24.02.2009 Për Miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2008 dhe synimet kryesore për vitin 2009”
- Fq.12 Vendimi nr.104, datë 25.02.2009 Për shpalljen e datës 3 mars të çdo viti si “Dita e konkurrencës” në Republikën e Shqipërisë
- Fq.14 Vendimi nr.105, datë 24.03.2009 “Për disa rekomandime dhe masa për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm TPL e brendshme”
- Fq.19 Vendimi nr.106, datë 23.04.2009 “Mbi autorizimin e përqendrimit për përfitim kontrolli të drejtpërdrejtë në ndërmarrjen Sigma ShA nga ndërmarrja Vienna Insurance Group, nëpërmjet blerjes së 87% të kapitalit”
- Fq.23 Vendimi nr.107, datë 23.04.2009 “Për marrje të dhënash me vendim Komisioni nga ndërmarrja “Taci Oil International Trading” Sh.A.”
- Fq.27 Vendimi nr.108, datë 23.04.2009 Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit në shoqërinë Austrian Airlines AG, nga shoqëria Deutsche Lufthansa AG nëpërmjet blerjes së 75% të aksioneve
- Fq.33 Vendimi nr.109, datë 04.05.2009 “Për rekomandim mbi rishikimin e pikës 1 të Vendimit të Këshillit Administrativ të ISKSH-së Nr.50, datë 12.12.2008”
- Fq.35 Vendimi nr.110, datë 15.05.2009 Për një rekomandim mbi projekt-ligjin “Për ofertat publike të titujve”
- Fq.37 Vendimi nr.111, datë 15.05.2009 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transaksionit të shitblerjes së 76 % të aksioneve të OSSH SH.A nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës tek shoqëria Cez a.s.”

- Fq.42 Vendimi nr.112, datë 15.05.2009 Për kërkim të dhënash nga Shoqëria “Albania AirLine MAK Shpk”
- Fq.44 Vendimi nr.113, datë 19.05.2009 Për “Ndalimin e marrëveshjes në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit midis ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a”
- Fq.46 Vendimi nr.114, datë 26.05.2009 Për kërkim të dhënash nga Shoqëria “Albania AirLine MAK Shpk”
- Fq.48 Vendimi nr.115, datë 26.05.2009 Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”
- Fq.52 Vendimi nr.116, datë 29.05.2009 Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes midis “Tirana International Airport” Shpk dhe “AIR BP Albania” Sh.a
“Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë, si dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 100, Datë 03.02.2009

**Mbi hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit të realizuar
nëpërmjet shitblerjes të 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine
MAK Shpk nga shoqëria Advanced Construction Group shpk**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Z. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.02.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit nga përftimi i kontrollit të plotë të shoqërisë Albania AirLines MAK Shpk nga shoqëria Advanced Construction Group shpk, nëpërmjet blerjes së kuotave.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti neni 59 “Procedura në mungesë njoftimi”. Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit, në lidhje me transaksionin e njoftuar,

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe informacionit të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut, të siguruar nga palët pjesëmarrëse në transaksionin e realizuar për përfitim të kontrollit të plotë në shoqërinë Albania AirLines MAK Shpk

V Ë R E N S E:

1. Shoqëritë Albania AirLines MAK Shpk dhe Advanced Construction Group Shpk në datën 04 Korrik 2008¹, kanë nënshkruar një marrëveshje me objekt shit-blerje kuotash.

¹ Sipas marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve të noterizuar

2. Ky transaksion, në kuptim të nenit 10, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, konsiderohet përqendrim.
3. Transaksioni përmbush edhe kriteret e përcaktuara në nenin 12, pika 1 e Ligjit dhe si rrjedhim duhet të njoftohet në Autoritetin e Konkurrencës, në afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
4. Blerësi, shoqëria Advanced Construction Group Shpk, nuk ka respektuar procedurën e njoftimit të përqendrimit

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 59 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

VENDOSI:

1. Të hapë me nismën e vet procedurën e kontrollit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes të 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine MAK Shpk nga shoqëria Advanced Construction Group Shpk.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)
Zv/Kryetar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 101, Datë 05.02.2009

“Për një shtesë në Vendimin Nr. 88 datë 02. 10. 2008 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Z. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.02.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për një shtesë në Vendimin Nr. 88 datë 02. 10. 2008 të Komisionit të Konkurrencës

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24 germa “d”

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

V Ë R E N S E:

Grupi i Punës, për realizimin e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, gjatë veprimtarisë së tij, ndër të tjera, ka kërkuar informacione nga institucionet përkatëse për ndërmarrjet nën hetim.

Nga të dhënat e sjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe përpunimi i tyre ka rezultuar se në tregun e importit të grurit gjatë vitit 2008 ka hyrë dhe një ndërmarrje e re, “GLAN” SHPK, e cila për periudhën Shkurt – 31 Gusht 2008 zotëron 9 % të pjesës së tregut të importit të grurit duke zënë kështu një pjesë të konsiderueshme në treg.

Referuar Ekstraktit Historik të publikuar online nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, të datës 06. 01. 2009, rezulton se kjo shoqëri është regjistruar si person juridik pranë QKR me Nr. K8141950D NIPT-i datë 19. 02. 2008, me seli në Durrës/Xhafzotaj, Godinë 1 katëshe Përballë ish – Metalikës. Kjo ndërmarrje ka si objekt të veprimtarisë së saj ndër të tjera dhe Import –Eksport të mallrave bujqësore.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të 24 germa “d” të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit;

VENDOSI:

1. Ndërmarrja “GLAN” Sh.p.k të përfshihet në hetimin e thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit.
2. Në pikën “I.” të pjesës urdhëruese të Vendimit Nr. 88 datë 02. 10. 2008 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit” të shtohet pika 11. “GLAN” SHPK.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 102, Datë 17.02.2009

Për rekomandime ndaj Projekt - Ligjit
“Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| • Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • Z. Lush Përpali | zv/kryetar |
| • Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| • Z. Koço Broka | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 17.02.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësimi i Projekt-Ligjit “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, gërma “f” dhe neni 69, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Shkresës Nr. 35/1 Prot datë 03. 02. 2009 të Institutit Kombëtar të Auditëve;

V Ë R E N S E:

Me anë të shkresës Nr. 35/1 datë 03. 02. 2009 Instituti Kombëtar i Auditëve i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës, vlerësimin e tij për projekt –ligjin “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Në bazë të nenit 69 të Ligjit 9121, datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës, jep vlerësime për projekt-aktet normative në lidhje me shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës si dhe me kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin, vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta në zona të caktuara për ndërmarrje ose produkte të caktuara dhe imponimin e praktikave të njëjta me çmimet dhe kushtet e shitjes.

Duke u bazuar në praktikat e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD – së, profesionet e lira, të tilla si avokatët, juristët, kontabilistët, farmacistët, mjekët, etj., janë subjekt i rregullimeve të veçanta, të tilla si kufizimet e reklamave, nivelet e komisioneve, të drejtave ekskluzive dhe rregullave për të ndaluar bashkëpunimin ndër-profesional, për shkak të sigurimit të një shërbimi profesional dhe cilësor.

Komisioni i Konkurrencës është i mendimit se, me anë të këtij projekt ligji, synohet rregullimi i funksionimit të shërbimeve të profesionit të ekspertit kontabël të autorizuar dhe profesionit të kontabilistit të miratuar nëpërmjet rritjes së mbikëqyrjes publike mbi këto profesione.

Pas shqyrtimit të Projekt–Ligjit “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, sipas mendimit të Komisionit të Konkurrencës, nuk konstatohet ndonjë dispozitë që bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24 germa “f” dhe nenit 69, pika 2, të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit;

VENDOSI:

1. Projekt–Ligji “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar” nuk përmban shkallë të kufizimit apo pengimit të konkurrencës në lidhje me ushtrimin e profesioneve të lira, në kuptim të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”;
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm t’ia komunikojë këtë vendim Ministrisë së Financave dhe palëve të tjera të interesuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)
Zv/Kryetar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 103, Datë 24.02.2009

Për Miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2008 dhe synimet kryesore për vitin 2009”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Z. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.02.2009 shqyrtoi materialin e paraqitur nga Sekretarja e Përgjithshme, të titulluar “Raporti vjetor i veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2008 dhe synimet kryesore për vitin 2009”.

Bazuar në nenet 24 , germa e dhe 29 germa ç të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pas shqyrtimit të projekt-raportit të paraqitur nga Sekretarja e Përgjithshme,

V ENDOSI:

1. Të miratojë Raportin Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2008 dhe synimet kryesore për vitin 2009” sipas raportit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Lush Përpali
()
Zv/Kryetar

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 104, Datë 25.02.2009

**Për shpalljen e datës 3 mars të çdo viti si “Dita e konkurrencës”
në Republikën e Shqipërisë**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Z. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shpalljen e datës 3 mars si ditë përkujtimore të konkurrencës në Republikën e Shqipërisë

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

KOMISIONI I KONKURRENCËS

V Ë R E N S E:

Konkurrenca është një instrument i domosdoshëm për tregun, e cila sjell rritjen e mireqenies ekonomike duke krijuar me shume mundesi zgjedhjeje për konsumatorët në një mjedis ekonomik ku ndermarrjet mund të veprojnë lirisht për arritjen e objektivave të tyre.

Për të patur një ekonomi sa më efikase dhe sa më konkurruese, rol të rëndësishëm luan zbatimi i Ligjit të Konkurrencës dhe i Politikës së Konkurrencës.

Në Republikën e Shqipërisë mbrojtja e konkurrencës realizohet nëpërmjet Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar). Qëllimi i këtij Ligji është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke mbikqyrur rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 43 datë 28. 12. 2006 në zbatim të këtij Ligji dhe për të krijuar një kulturë konkurrence në mjedisin shqiptar, ka miratuar dhe Politikën Kombëtare të Konkurrencës, i cili është një dokument i rëndësishëm për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës ka marrë vendimin e parë të tij në datën 03. 03. 2004, i cili është dokumenti i parë që tregon funksionimin e tij si institucion i pavarur.

Autoriteti i Konkurrencës në bazë të politikës kombëtare të konkurrencës ka si qëllim parësor që një ndër rrugët e rëndësishme për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg është krijimi i një kulture konkurrence në mjedisin shqiptar.

Për te nxitur kulturen e konkurrencës krahas aktiviteteve të vazhdueshme është vlerësuar që data 3 mars e çdo viti të shpallet dita e konkurrencës në Republikën e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar dhe në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Data 3 Mars e çdo viti të shpallet Dita e konkurrencës
2. T’i propozojë Këshillit të Ministrave që në bazë të nenit 95 pika 2 dhe 100 të Kushtetutës si dhe nenit 1 pika “a” të Ligjit Nr. 7651 datë 21. 12. 1992 “Për festat zyrtare dhe ditët përkujtimore”, që të shpallë datën 3 Mars të çdo viti, si ditë përkujtimore në Republikën e Shqipërisë;
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)

Zv/Kryetar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 105, Datë 24.03.2009

“Për disa rekomandime dhe masa për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm TPL e brendshme”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| • Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • Z. Lush Përpali | zv/kryetar |
| • Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| • Z. Koço Broka | Anëtar |
| • Znj. Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 24.03.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Raporti i Hetimit të Thelluar në Tregun e Sigurimeve për Produktin e sigurimit të detyrueshëm, TPL e Brendshme

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, dhe neni 70/2 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të vendimit nr. 45, datë 19.01.2007 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e sigurimeve për produktin TPL”, pas shqyrtimit të Raportit të Hetimit të Thelluar në Tregun e Sigurimeve për Produktin e sigurimit të detyrueshëm, TPL e Brendshme, të hartuar nga Grupi i Punës,

V Ë R E N S E:

1. Palët nën hetim:

- Shoqëria “Siguracioni Shqiptar”, ShA (Sigal),
- Shoqëria “Siguria e Madhe” ShA (Sigma),
- Shoqëria InterAlbanian ShA,
- Shoqëria Atlantik ShA,
- Shoqëria Intersig ShA’

- Shoqëria “Albsiguracione” (Albsig),
- Shoqëria Eurosig ShA (Ish “Dukagjini”)

Palët e mësipërme në bazë të aktit të themelimit të datës 16.01.2006, kanë realizuar, krijimin e një ndërmarrje të përbashkët, Agjensia e Sigurimit të Automjeteve SHA, për tregtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm TPL e brendshme.

Shoqëria ASA është regjistruar në Gjykatën e Tiranës në datë, me vendimin 35162 datë 9.3.2006 dhe është licencuar nga Autoritetit i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, me Licencën Nr 4, datë 12.04.2006 “Për ushtrim veprimtarie agjenti në sigurime”. Kjo shoqëri ka filluar ushtrimin e veprimtarisë së saj në Qershor 2006. Qëllimi kryesor i saj ishte tregtimi i produktit TPL e brendshme me anë të një sistemi on-line. Kjo është bërë në bazë të detyrimit të përcaktuar në VKM nr. 192 të vitit 2005 “për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre”.

Në dhjetor të vitit 2006 kanë filluar ushtruar veprimtarinë e tregtimit të produktit të sigurimit të detyrueshëm me anë të sistemeve on-line vetë shoqëritë e sigurimit. Në mars 2007 ASA përfundimisht e ka ndërprerë veprimtarinë faktike të saj megjithëse vazhdon të jetë e regjistruar në gjykatë si dhe e licencuar nga AMF.

2. Tregu Përkatës

a. Tregu i produktit: Tregtimi i produktit të sigurimit të detyrueshëm të mbajtesve të mjeteve motorike T.P.L e brendshme.

T.P.L e brendshme është një kontratë me afat 1 vjeçar, forma dhe përmbajtja e së cilës miratohet nga Ministri i Financave. Ky produkt hyn në klasën e sigurimeve të detyrueshme dhe është unik në llojin e vet, pra nuk ka zëvendësues.

b. Tregu gjeografik: Territori i Shqipërisë

3. Pjesët e tregut

3.1. Për vitin 2006, tetë shoqëri sigurimi ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin nivel tregu (tregu i rrjedhës së sipërme), duke zotëruar secila: Sigal (27.34%); Sigma (18.40); Atlantik (11.39%); Intersig (8%); Interalbani (7.05%); Albsig (5.95%); Eurosig (3.23%) dhe Insig (18.64%).

Nisur nga numri i shoqërive që veprojnë në treg, mund të themi që tregu shfaqet si një treg oligopol.

3.2. Në nivelin e tregtimit të produktit TPL e brendshme (tregu i rrjedhjes së poshtme) kanë vepruar në periudhën mars 2006-dhjetor 2006 vetëm dy agjentë: ASA dhe INSIG, me pjesë tregu respektive (82.78%) dhe (17.22%). Tregu ka karakteristikat e një tregu duopol. Tregtimi i produktit realizohet nga këto dy shoqëri vetëm në sistemin on-line.

Ndarja e tregut të tregtimit ndërmjet dy ndërmarrjeve (ASA dhe Insig), mundësoi INSIG për të zgjeruar pjesën e tij të tregut me këtë shërbim.

4. Analiza e konkurrencës

- 4.1 Tregu i sigurimeve është treg i rregulluar. Agjensia e Mbikqyrjes Financiare (AMF) është rregullatori specifik i tregut të sigurimeve.
- 4.2 Tregtimi i produktit TPL i brendshëm vetëm me anë të ndërmarrjes së përbashkët ASA, për periudhën Qershor– Dhjetor 2006, ka sjellë ndryshime në strukturën e tregut të sigurimeve në nivelin e tregimit të produktit, si dhe ka ndikuar në nivelin e konkurrencës në treg. Ky përqendrim i tregimit vetëm tek një agjent, reduktoi në mënyrë të ndjeshme numrin e konkurrentëve në tregun e tregimit të produktit TPL e brendshme.
- 4.3 Instalimi i sistemit të informatizimit të rrjetit, (sistemi on-line) në shoqërinë A.S.A, si rezultat i detyrimit që buron nga aktet ligjore dhe brishtësisë së AMF për mbikëqyrjen e tregut, mundësoi forcimin e kontrollit të këtij tregu pothuajse informal nga ana e rregullatorit specifik AMF.
- 4.4 Shoqëritë e sigurimit, minimizuan abuzimin me shitjen e policave të sigurimit, duke rritur të ardhurat e arkëtueshme të primit të rrezikut, e duke përmirësuar cilësinë e shërbimit ndaj klientit për të përballuar dëmet e shkaktuara.
- 4.5 Shoqëria A.S.A nuk ka vepruar si agjent i pavarur në treg. Tregtimi i produktit në mënyrë të përqendruar vetëm tek A.S.A, lehtësoi bashkërendimin e sjelljes së shoqërive për sa i takon vendimeve të rëndësishme.
- 4.6 Shoqëritë e sigurimit nëpërmjet ndarjes së ngushtë të tregut të TPL, detyruan konsumatorët për t'u siguruar tek një furnizues i caktuar, duke u kufizuar atyre mundësinë e zgjedhjes, e cila ndikon në uljen e cilësisë së shërbimeve për ta.
- 4.7 Aktet nënligjore, të dala nga Ministri i Financave, në periudhën në hetim, përcaktonin kufirin minimal dhe maksimal të primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm dhe elementë të tjerë lidhur me shitjen dhe administrimin e policave të sigurimit. Urdhri i Ministrisë të Financave nr 12, datë 18.04.2006 “Për miratimin e primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorikë për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”- në pikën 2 të tij përcakton një marzh prej 20-25 %, për shpenzimet që do të shtohen primit të pastër. Kjo do të thotë që shoqëritë nuk duhej të zbatonin të njëjtin çmim për produktin TPL, ndërsa në fakt tregtimi i policave të sigurimit nga ASA bëhej me të njëjtin çmim.
- 4.8 ASA ka funksionuar për një periudhë afat-shkurtër në treg (qershor – dhjetor 2006) si agjent i vetëm për tregtimin on-line të produktit TPL. Aktualisht Shoqëria ASA, de jure zotëron licencën për ushtrim veprimtarie si agjent, por de facto nuk është e pranishme në treg që nga dhjetori i vitit 2006 .

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, shkronjat d dhe f, dhe nenit 70/2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

VENDOSI:

Ti rekomandojë Autoritetit Mbikqyrjes Financiare që:

1. Të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që mund të ketë pasoja mbi konkurrencën në treg.
2. Të kërkojë opinionin e Autoritetit për çdo ndryshim në lidhje me strukturën e tregut të sigurimeve, që mund të sjellë pasoja për konkurrencën.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

(_____)
Zv/Kryetar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

**Argumetimi i votës kundër për Vendimin Nr . Datë 03. 2009 “ Për
Disa rekomandime dhe masa për rivendosjen e konkurrencës në tregun e
sigurimit të detyrueshëm TPL e brendshme ”**

Lidhur me vendimin e mesipërm, shpreh votën kundër për keto arsye:

1. Në këtë akt vihet re një qëndrim eklektik evaziv, që nuk pasqyron shmang dhe nuk përputhet me qëndrimet e mbajtura në vendimet e mëparshme të Komisionit, në diskutimet në mbledhjet e Komisionit, datë 19.01.2007, 12.3.2009; në informacionet dhe Raportet e Grupeve të Punës. -Informacioni për hetimin paraprak Janar 2007; Mbi Raportin e Hetimit të Thelluar në tregun e sigurimeve për produktin TPL e brendshme, datë 23 .2.2009, Relacionin e Sekretarës së Përgjithshme 23.2. 2009, Vendimin Nr 45 Date 19.01.01.2007 të Komisionit të Konkurrencës “ Për Hapjen e procedurës së Hetimit të thelluar në tregun e sigurimit për produktin TPL (TPL e brendshme, Policë Kufitare, Karton Jeshil) ; ftësen drejtuar Shoqërive të Sigurimit për seancën degjimore në muajin Shkurt 2009, shkresat drejtuar Znj Jozefina TOPALLI (ÇOBA) - Kryetare e Kuvendit; z Fatos BEJA- Kryetar i Komisionit Parlamentar të Ligjeve. Z Edmond SPAHIO-Kryetar i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë. korespondenca ime e brendshme me Grupin e Punës dhe Sekretarën e Përgjithshme për një proces sa më të rregullt të hetimit të Shoqërive të Sigurimit etj

2. Vendimarrja nuk adresohet në shkeljen ose mosshkeljen e Ligjit Nr 9121, datë 27.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” nga veprimtaria e Shoqërisë ASA, të marrë nën hetim por vetëm për disa Rekomandime dhe masa për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm TPL e brendshme- drejtuar Autoritetit Mbrojtës Financiare. Personalisht mbështes idenë se Komisioni i Konkurrencës, duhet të shprehet për faktin se ASA është e ndaluar në kuptimin e nenit 4, pika 1, germa a, b, c) apo Nenit. 10,12 . 53 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar) , pamvarësisht ndryshimeve që kanë ndodhur në veprimtarinë e ASA-s, mbi bazën e gjetjes të shumicës të grupit të punës, provave dhe fakteve të sjella

24.3.2009

Koço Broka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 106, Datë 23.04.2009

“Mbi autorizimin e përqendrimit për përftim kontrolli të drejtpërdrejtë në ndërmarrjen Sigma ShA nga ndërmarrja Vienna Insurance Group, nëpërmjet blerjes së 87% të kapitalit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| • Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • Z. Lush Përpali | zv/kryetar |
| • Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| • Z. Koço Broka | Anëtar |
| • Znj. Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 23.04.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Njoftimi i përqendrimit për përftimin e kontrollit të realizuar nëpërmjet blerjes të 87% të aksioneve në ndërmarrjen Sigma sh.a nga Viena Insurance Group.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Mbi formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Aneksi I- Formulari i thjeshtuar i njoftimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi përqendrimin e njoftuar,

V Ë R E N S E:

Palët pjesëmarrëse:

1. TBIH Financial Servis Group N.V (TBIH)”, në cilësinë e shitësit, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hollandez, me seli në adresën Claude Debussylaan 30, Kati 13, 1082 MD, Amsterdam, Hollandë.

Veprimtaria kryesore e TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH)” është shërbim në fushën e sigurimeve dhe të pensioneve. Aksionerët e TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH) janë Vienna Insurance Group që zotëron 60 % të aksioneve dhe Kardan Financial Services B.V me 40 % të aksioneve.

2. Vienna Insurance Group (VIG), në cilësinë e blerësit, është shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit austriak, me seli në adresën Schottering 30, 1010 Vienë, Austri.

Veprimtaria kryesore e VIG është sigurimi i jetës, përfshirë sigurimet suplementare, të shëndetit etj, e licensuar nga Autoriteti Mbikqyrjes së Sigurimeve austriak. Vienna Insurance Group ka kontrolluar që prej vitit 2007¹ në mënyrë të tërthortë nëpërmjet shoqërisë TBIH, veprimtarinë e ndërmarrjes Sigma SHA.

3. Shoqëria brenda së cilës ndodh transaksioni është ndërmarrja Sigma SHA, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli në adresën “Komuna e Parisit”, Pallatet “Lura”, Kati I, Tiranë.

Veprimtaria e ndërmarrjes Sigma SHA është sigurimi i jetës dhe jo jetës, sipas licensës Nr 1, datë 3.2.1999 dhe lejes së vitit 2002, të lëshuar nga Komisioni Mbikqyrjes së Sigurimeve, sot Autoriteti Mbikqyrjes Financiare.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 39.627 aksione me vlerë nominale prej xxxxxx lekë secili, i ndarë ndërmjet 5 aksionerëve, ku më i madhi zotëron 87% aksion dhe 4 të tjerët nga 1%-6%.

Operacioni

4. Aksioneri TBIH Financial Servises Group (TBIH), zotërues i pjesën 87% të kapitalit në ndërmarrjen Sigma SHA, i shet këtë pjesë aksionerit të vet mazhoritar, shoqërisë Vienna Insurance Group. Pas përfundimit të operacionit, TBIH pushon së ekzistuari dhe Vienna Insurance Group fiton kontrollin e drejtpërdrejtë në ndërmarrjen Sigma ShA.

Vlera e transaksionit është xxxxx Milion Euro dhe do të realizohet ekskluzivisht nga burimet e Vienna Insurance Group.

Arsyet ekonomike të përqendrimit

5. Transaksioni i realizuar, që sjell ndryshimin e kontrollit, nëpërmjet blerjes së kapitalit aksionar prej 87% është në përputhje me strategjinë e Vienna Insurance Group, për të zgjeruar veprimtarinë e saj në tregun e sigurimit të jetës dhe jo jetës në vendet e Europës Jug lindore.

6. XHIRO NË TREG:

- A. Xhiro totale në tregun ndërkombëtar për vitin 2007 është xxxx miliard Euro = xxxxx miliard lekë², e ndarë:

- Vienna Insurance Group për vitin 2007 është xxx miliard Euro = xxxx miliard lekë ; dhe
- Sigma ShA (degëve ose filialeve të saj në Maqedoni dhe Kosovë) është xxxxx milionë Euro = xxxx miliard lekë

¹ Vendimi Nr 55, datë 11.9.2007 i Komisionit të Konkurrencës

² Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007, 1 euro=123 lek. Burimi: Buletini zyrtar

- B. Xhiro totale në tregun kombëtar për vitin 2007 e Sigma sha është xxxx miliard lekë, ndërsa për vitin 2008 = xxxx miliardë lekë

7. TREGU PËRKATËS

a. Tregu i produktit

Në përputhje me veprimtarinë që ushtrojnë palët, për vlerësimin e këtij përqendrimi, treg përkatës të produktit do të konsiderojmë ofrimin e shërbimit të sigurimit motorrik, sigurimin e jo-jetës dhe pensionet vullnetare.

- TBIH ushtron veprimtari në fushën e sigurimeve dhe të pensioneve në tregun europian dhe në vendet e Europës Lindore. Është e pranishme në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës dhe jo jetës, që prej vitit 2006, në shoqërinë Sigma SH A.
- Vienna Insurance Group ushtron veprimtarinë e saj në sigurimin e jetës, përfshirë dhe sigurimet suplementare, sigurimin e shëndetit, mbulimin në raste fatkeqësish, si dhe sigurim i pronës, sigurim i humbjeve financiare, në klasat e autorizuara. Është e pranishme në tregun shqiptar nëpërmjet TBIH prej vitit 2006.
- Sigma Sh.A ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me licensën në tregun e sigurimit të jo jetës dhe gjithashtu ushtron veprimtari indirekte në tregun e pensioneve vullnetare nëpërmjet kontrollit 75% të kapitalit në ndërmarrjen Sigma IPP Sh.A

Tregu i sigurimeve të jo-jetës

8. Në tregun shqiptar të sigurimeve të jo-jetës ushtrojnë veprimtarinë e tyre 8 shoqëri. Për vitin 2008, ky treg realizoi një volum primesh të nënshkruara bruto me një vlerë prej 6.5 miliardë lekë, me një rritje prej 19% krahasuar me vitin 2007, nga të cilat 1 miliardë lekë dhe një rritje prej 3.6% ishte kontributi i Sigma SH.A.

Tregu është i orientuar kryesisht në sigurimet e jo-jetës, të cilat përbëjnë 92.7 % të tregut të përgjithshëm të sigurimeve. Pjesa e tregut që zë ndërmarrja Sigma Sh.A është 15.47%. Konkurrentët kryesorë të shoqërisë Sigma sh.a me pjesë tregu respektive janë: Sigal (27.16 %); Insig (15.15 %); Atlantik (11.52%); Interalbanian (10.55%); Albsig (7.97%); Intersig (7.65%); Eurosig (4.53%) etj.

Tregu i sigurimeve të jo jetës ndahet në: (a) Sigurime motorrike dhe (b) Sigurime vullnetare.

Primi bruto i realizuar nga Sigma Sh.A në tregun e sigurimeve motorrike për vitin 2008 arriti vlefën xxxx mijë lekë dhe i ndarë sipas produkteve (TPL e brendshme - xxxx mijë lekë ose 17% e tregut; Karton Jeshil-xxx mijë lekë ose 18% të tregut; Policë kufitare - xxx mijë lekë ose 15% të tregut dhe Kasko xxx mijë lekë ose 14% të tregut.

9. Tregu i pensioneve private vullnetare : Në tregun e pensioneve private vullnetare, në vitin 2008, ushtrojnë veprimtarinë e tyre 3 shoqëri, me pjesë tregu për vitin 2008, respektivisht: Sigma IPP (17.56%); IAPPSH (42.5%); dhe Capital (39,94%), me një numër total prej 3861 kontribuesish, që arrijnë vlerën prej xxxx milion lekësh.

b. Tregu gjeografik

Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara, përcaktuar në tregun e produktit. Transaksioni sjell ndryshime vetëm në strukturën e shoqërisë dhe nuk shkakton ndryshime të strukturës së tregut të sigurimeve, për sa i përket pjesës së tregut që zë shoqëria Sigma sha. Tregu përkatës gjeografik është konsideruar tregu i brendshëm/ territori i Republikës së Shqipërisë.

10. Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit të paketës prej 87% nga Vienna Insurance Group dhe nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të sigurimeve dhe tregut të pensioneve private.
11. Transaksioni i shitblerjes së aksioneve në Sigma Sh.A realizon ndryshimin e formës së kontrollit nga kontroll i përbashkët indirekt, në kontroll të vetëm direkt.
12. Në këtë kontekst përqëndrimi nuk mund të ketë efekte antikonkurruese duke qënë se në kuptimin e nenit 13, pika 1 e Ligjit, pasi nuk rrezikon të krijojë ose të forcojë pozitën dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqëndrim. Pra, nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqëndrimi dhe krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

VENDOSI:

Ti rekomandojë Autoritetit Mbikqyrjes Financiare që:

1. Të autorizojë, përqëndrimin e realizuar që sjell ndryshimin e formës së kontrollit, nëpërmjet blerjes së pjesës 87% të aksioneve në shoqërinë Sigma sh.a nga Viena Insurance Group.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot me datë 23.04.2009

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 107, Datë 23.04.2009

“Për marrje të dhënash me vendim Komisioni nga ndërmarrja “Taci Oil International Trading” Sh.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Z. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.04.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Kërkim të dhënash nga ndërmarrja “Taci Oil International Trading” Sh.A nëpërmjet Vendimit të Komisionit.

Qëllimi: Marrje e të dhënave nga të gjitha ndërmarrjet nën hetim për një vendimmarrje objektive, para shprehjes së Komisionit lidhur me sjelljen e ndërmarrjeve në treg dhe kufizimet që sjellin aktet ligjore dhe nënligjore në tregun e karburanteve.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, dhe neni 33/2 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V Ë R E N S E:

Autoriteti i Konkurrencës, ka filluar një hetim në tregun e karburanteve në bazë të vendimit Nr. 74 datë 11.03.2008 “Për Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve”, të Komisionit të Konkurrencës. Në vazhdim të procedurave Komisioni i Konkurrencës ka organizuar seanca dëgjimore me të gjithë ndërmarrjet nën hetim. Gjatë seancave dëgjimore nga Komisioni i Konkurrencës janë realizuar pyetje të ndryshme të nevojshme për një vendimmarrje sa më të drejtë e transparente. Ndërmarrja “Taci Oil International Trading” Sh.A. nuk ka marrë pjesë në seancë dëgjimore.

Me anë të shkresës Nr. 137, datë 20.03.2009, “Për kërkim informacioni”, nga ana e Autoritetit të Konkurrencës i është kërkuar ndërmarrjes që të sjellë informacionin përkatës brenda datës 10.04.2008. Edhe pas kalimit të këtij afati, ndërmarrja “Taci Oil International Trading” Sh.A. nuk ka sjellë informacionin e kërkuar.

Komisioni i Konkurrencës, sipas nenit 33 pika 2, mund të kërkojë informacion me anë të një vendimi. Në rast se ndërmarrjet japin të dhëna jo të sakta, jo të plota ose mashtruese, ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e marrë, Komisioni vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, në bazë të nenit 73 pika 1 germa a) të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, shkronja d si dhe nenit 33/2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

VENDOSI:

1. Ndërmarrja “Taci Oil International Trading” Sh.A. për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2007, të sigurojë informacionin si më poshtë:
 - a) Çmimi i blerjes në USD ose në njësi tjetër monetare (ashtu siç është blerë), të faturës së blerjes.
 - b) Sasia e karburantit, të specifikuar benzinë, Eurodiesel (D1 ose D2)
 - c) Shpenzimet e transportit, duke specifikuar se e keni sjellë me mjetin tuaj apo me qera.
 - d) Shpenzimet e tjera deri tek vlera ose çmimi i zhdoganimit. Këto të dhëna të jenë në monedhën përkatëse të realizuar dhe të konvertuar edhe në lek duke pasqyruar kursin e këmbimit me të cilin është konvertuar.
 - e) Çmimin e referencës të përdorur në madhësi absolute pra jo vetëm po ose jo, por dhe sa konkretisht në trajtë absolute.
 - f) Kursi i këmbimit të përdorur dhe sa ka qenë ai për çdo deklaratë doganore. Në rastet kur ka qenë i ndryshëm nga kursi mujor i këmbimit të publikuar në doganë të pasqyrohet i specifikuar.
 - g) Detyrimet doganore të detajuara për çdo lloj detyrimi (akcizë, taksë karboni, TVSH etj.)
 - h) Vlera e tatimeve të pasqyruara në Bilancin Financiar për periudhën 01.01.2007-31.12.2007 (detajuar sipas llojit të tatimit).
 - i) Gjendjen e karburantit në fillim të vitit 2007 dhe në fund të vitit 2007, për çdo lloj karburanti që keni importuar dhe gjithsej, pra sa ka qenë gjendja juaj sipas bilancit në vlerë, por edhe në sasi sipas pasqyrave mbi të cilin është ndërtuar bilanci.
 - j) Të dhënat e kërkuara në pikën 8 dhe 9 të sillen edhe për ndërmarrjen tuaj të integruar vertikalisht (Shpk).

- k) Sa ka qenë sasia e shitur e çdo lloj karburanti, duke specifikuar gjendjen në sasi dhe në vlerë në fillim të vitit 2007 dhe në fund të vitit 2007.
- l) Sigurimin e Raporteve të rivlerësimeve tatimore për periudhën 1 Janar– 31 Dhjetor 2007.
2. Afati i fundit për paraqitjen e këtij informacioni pranë Autoritetit të Konkurrencës është data 04 maj 2009.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

(_____)
Zv/Kryetar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

Mendimi kunder

Ne lidhje me Vendimin nr date 23.04.2009 te Komisionit te Konkurrences "Per kerkim informacioni nga ndermarrja – Taci Oil International Trading Sh.A.- "

Vota kunder ketij vendimi ka te beje kryesisht me faktin se ky vendim paraqet nje procedure krejtesisht te parregullt. Konkretisht:

Qellimi i vendimit te mesiperm eshte te detyroje ndermarrjen e mesiperme qe te siguroje te dhenat e listuara ne vendim ose ne te kundert do te penalizohet ne baze te nenit 73 te ligjit "Per mbrojtjen e Konkurrences"

Ndonse parimisht sigurimi i te dhanve nga subjektet per Autoritetin e Konkurrences eshte e detyruar sipas ligjit, vendimi i mesiperm e ka humbur kuptimin e tij pasi ai merret shume kohe pasi hetimi ndaj ndermarrjeve, perfshire edhe "Taci Oil" eshte deklaruar i mbyllur nga sekretariati i Autoritetit te konkurrences, si i vetmi organ i ngarkuar me ligj per te kryer hetime ne lidhje me konkurrencen. *(Shih njoftimin zyrtar te Autoritetit te Konkurrences " Autoriteti i Konkurrences perfundon raportin "Mbi hetimin e Thelluar ne Tregun e Karburanteve" dhe fton ndermarrjet ne seance degjimore", botuar edhe ne fagen zyrtare te A.K me date 16.12.2008.)*

Palet thiren ne seance degjimore per tu degjuar , pra per te shprehur pretendimet e tyre dhe jo per tu penalizuar per pretendimet e komisionereve. Sekretariati ka patur gjithë kohën ne dispozicion per te kerkuar te dhena me vendim te komisionit ne kuptimin e mesiperm, kur sigurimi i tyre nuk eshte realizuar ne rruge normale nga ndermarrjet gjate kohes qe hetimi ishte ne proces.

Pas perfundimit te hetimit nga grupi i punes dhe dorzimi per vendimemarrje ne komision, pra kalimit te materialit ne procesin e vendimemarrjes, hetimi mund te rifilloje ose te plotesohet vetem me vendim te vecante te komisionit, kur hetimi i realizuar nuk e ka arritur qellimin e vet, dhe vetem ne keto kushte mund te filloje kerkimi i te dhenave per te plotesuar hetimin sipas detyrave te lena nga vendimi i Komisionit. Ne kete shtate grupi i punes mund te filloje cdo gje nga e para , pra edhe kerkimin e te dhenave me vendim komisioni kur dhenja e tyre refuzohet nga ndermarrjet.

Perveç kesaj te dhenat e kerkuara sipas listimit ne vendimin e mesiperm nuk sjellin asgje te re per komisionin per te gjykuar nese kompanite kane abuzuar apo jo duke realizuar sjellje te kordinuar midisi tyre sic pretendohet ne raportin e sekretariatit.

Vendimi i mesiperm peshtjellon keq procedurat qe duhet te ndiqen ne hetimet ndaj subjekteve ekonomike, ne kuptimin e fillimit dhe te mbarimit te tije, ne zbatimin e ligjit dhe qendrimin korrekt ndaj subjekteve qe hetohen. Ai perben nje precedent te keq per punen e Autoritetit te Konkurrences per te ardhmen

Per keto arsye dhe per te tjera te shprehura ne mbledhjen e Komisionit, kam votuar kunder ketij vendimi dhe kerkoj qe ky shpjegim ti bashkangjitet vendimit te lartpermandur.

Lush Perpali
Zv/ Kryetar



Tirane me 23.04.2009



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 108, Datë 23.04.2009

MBI

Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit në shoqërinë Austrian Airlines AG, nga shoqëria Deutsche Lufthansa AG nëpërmjet blerjes së 75% të aksioneve

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| • Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • Z. Lush Përpali | zv/kryetar |
| • Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| • Z. Koço Broka | Anëtar |
| • Znj. Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 23.04.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar për përfitim e kontrollit në shoqërinë Austrian Airlines AG, nga shoqëria Deutsche Lufthansa AG nëpërmjet blerjes së 75% të aksioneve.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, 10-12, Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53-56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Aneksi I-Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit dhe Relacionit të Sekretares së Përgjithshme bashkëlidhur këtij raporti

V Ë R E N S E:

I. Palët:

1. Shoqëria **Deutsche Lufthansa AG** (këtu e më poshtë referuar si “**Lufthansa**”), në cilësinë e **blerësit**, është një shoqëri aksionere e grupit Lufthansa, me seli në Këln, Gjermani.

Lufthansa operon në transportin ajror, me një numër prej 513 avionësh në 208 destinacione në më shumë se 85 vende dhe me një numër mesatar të pasagjerëve prej 62.9 milion.

2. Shoqëria **Austrian Airlines AG** (këtu e më poshtë referuar si “**Austrian**”), në cilësinë e **shitësit**, është një shoqëri anonime me seli në Vienë, Austri. Shoqëria operon në transport ajror, fluturime, me 100 avione në 130 destinacione në 59 vende, me një numër mesatar të pasagjerëve prej 10.8 milion.
3. Austrian AirLines dhe Lufthansa bashkëpunojnë si një sipërmarrje të përbashkët që nga Marsi i vitit 2000: (i) në mbulimin e të gjitha koridorëve ndërmjet Austrisë dhe Gjermanisë, (ii) në një ndarje reciproke të shërbimit kod dhe ndarje të të ardhurave, (iii) në ofrimin e shërbimeve të përbashkëta për klientët, si psh fluturime të përbashkëta dhe ofrimin e programit “Mile & More”.

Palë të tjera pjesëmarrëse për realizimin e përqendrimit

4. **Osterreichische Industrieholding Aktiengesellschaft (OIAG)**, është një shoqëri aksionere me pronësi shtetërore me seli në Vienë, Austri. OIAG zotëron 41.56% në kapitalin e shoqërisë Austrian Air Lines.
5. **Gomele Beteiligungsverwaltungs GbmH (StraCo)**, filial i zotëruar 100% nga shoqëria Lufthansa, është një shoqëri aksionere, me seli në Vienë, Austri.
6. **Austrian Private Foundation (APF)**, është një fondacion privat austriak me seli në Vienë, Austri; i krijuar me qëllim sigurimin e kontrollit të pjesës mazhoritare në fazën e parë të transaksionit në shoqërinë Austrian Airlines.
7. **Sobire Beteiligungsverwaltungs GbmH (NewCo)**, një shoqëri aksionere me seli në Vienë, Austri. Shoqëria NewCo përfaqëson Lufthansën në Marrëveshjen Kuadër për blerjen e pjesës 41.56% në shoqërinë Austria AirLines dhe gjithashtu është e ngarkuar për blerjen e 75% të aksioneve me Ofertë Publike.

II. Operacioni

8. Në 5 dhjetor 2008, shoqëri të veçanta si **OIAG, Lufthansa, StratCo, NewCo, APF** dhe **Austrian Airlines**, kanë nënshkruar një Marrëveshje Kuadër, me qëllim realizimin e procesit, nëpërmjet të cilit Lufthansa do të fitojë kontrollin e 75% të kapitalit aksionar tek Austria AirLines. Për shkak të strukturës komplekse të transaksionit, detyrimit së aksionerit me pronësi shtetërore (OIAG) për të zbatuar kushtet e diktuar nga Qeveria austriake në Mandatin e Privatizimit dhe në veçanti për të siguruar të drejtat e trafikut me vendet e treta, përfshirë i kontrollit është strukturuar në disa hapa. Një strukturë holding që përfshin krijimin e **APF** dhe **NewCo** janë krijuar për të realizuar blerjen në shoqërinë Austrian AirLines. NewCo është shoqëri e kontrolluar bashkërisht nga APF (50%) dhe indirekt nga Lufthansa, nëpërmjet StratCo (50%).
9. **OIAG**, në cilësinë e **shitësit** dhe **NewCo** në cilësinë e **blerësit**, kanë nënshkruar marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve për pjesën 41.56% të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës në Shoqërinë Austrian. Me transferimin e aksioneve nga OIAG tek NewCo shoqëria Lufthansa (nëpërmjet StratCo) do të jetë aksionere në mënyrë indirekte e shoqërisë Austria Airlines. Transaksioni që realizon blerjen e 41.56% nuk përbën një përqendrim, sepse (i) situata pas blerjes nuk përbën një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit, (ii) krijimi i ndërmarrjes së përbashkët NewCo, është tranzitor dhe në zbatim të kushteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër do të konvertohet në një kontroll të vetëm nga Lufthansa.

10. Shoqëria Lufthansa synon të marrë kontrollin e vetëm nëpërmjet realizimit të Ofertës Publike, pas së cilës ajo do të jetë zotëruese e të paktën 75% të aksioneve të shoqërisë Austria.

IV. Arsyet ekonomike të përqendrimit

11. Transaksioni i propozuar do të ndihmojë që Austrian Airlines të sigurojë jetëgjatësi afatgjatë me brandin dhe menaxhimin e saj, duke i dhënë Lufthansës një rol kyç në rrjetin e saj të zgjeruar të qendrave të lidhjes edhe për destinacionet e vendeve të Europës Lindore dhe Lindjes së Mesme.
12. Vlera e këtij transaksioni është 36.626.875 Euro

V. XHIRO për vitin 2007

14. Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është xxx miliard Lekë, ku:
- Deutsche Lufthansa AG : 22 miliard Euro¹ = **xxx miliard lekë**
 - Austrian Airlines AG : 2.4 miliard Euro = **xxx miliard lekë**
15. Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është 1miliard xxx mil Lekë, ku:
- Deutsche Lufthansa AG : 2.3 milion Euro = **xxx milion Lekë**
 - Austrian Airlines AG : 9.3 milion Euro = **xxx miliard lekë**

VI. Tregu Përkatës

Në tregun përkatës të produktit dhe atë gjeografik shoqëritë Austrian Airlines AG dhe Deutsche Lufthansa AG janë aktive në katër fusha: a) Shërbimi i transportit ajror të pasagjerëve, b) Shërbimi i transportit ajror të kargos, c) Shërbime të mirëmbajtjes dhe riparimit të avionëve, d) Shërbimi katering.

16. **Tregu përkatës i produktit në Shqipëri:** Palët janë prezent në tregun e transportit ajror të pasagjerëve dhe të transportit ajror të kargos. Për këtë arsye treg përkatës të produktit do të konsiderojmë shërbimin e transportit ajror të pasagjerëve dhe transportit ajror të kargos.
17. **Tregu përkatës gjeografik:** Për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet **tregu i brendshëm/territori i Republikës së Shqipërisë.**

VII. Vlerësimi i Konkurrencës

18. Shërbimi i transportit ajror të pasagjerëve

Referuar rasteve të përqendrimeve të shqyrtuara nga Komisioni Europian², në mënyrë tradicionale, tregu përkatës i transportit ajror është përcaktuar mbi bazën e linjave të veçanta dhe grupit të linjave (bundle of routes). Ndërsa për përcaktimin e tregut të shërbimit të transportit ajror të pasagjerëve, përdoret përqsja e çiftit pikë origjine/pikë destinacioni (O&D). Sipas këtij

¹ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007, 1 euro=123.6 lek. Burimi:Raporti Statistikor

² Airline Alliances and Mergers; Rastet e Komisionit në COMP/M.4439 - Ryanair/Aer Lingus, paras. 65-66, rasti nr. COMP/M.3770 - Lufthansa/Swiss, para. 12 vazhdim, dhe rasti nr COMP/M.3280 - Air France/KLM, para. 9 vazhdim.

vlerësimi, çdo kombinim i pikës së origjinës dhe pikës së destinacionit, i parë nga këndvështrimi i zëvendësueshmërisë së kërkesës nga konsumatori, konsiderohet si treg me vete. Për të vlerësuar se kur një çift O&D formon një treg përkatës produkti, merren parasysh jo vetëm linjat direkte ndërmjet dy aeroporteve, por edhe alternativa të tjera që shihen si zëvendësues të afërt me këto linja. Në këtë kontekst, realizimi i përqendrimit nuk sjell mbivendosje në ofrimin e shërbimit të transportit ajror të pasagjerëve, mbasi shoqëritë Lufthansa AG dhe Austrian Airline AG, nisur nga Tirana, kanë destinacione të ndryshme fluturimi.

- Deutsche Lufthansa AG (Tiranë/Mynih dhe anasjelltas) është aktive në ofrimin e shërbimeve direkt të transportit ajror të pasagjerëve, me distancë relativisht të shkurtër rreth 616 milje, çdo ditë të javës (me frekuencë 7 herë në javë) duke arritur një numër rreth 65 276 pasagjerësh në vit ; ndërsa
- Austrian Airlines AG (Tiranë/Vienë dhe anasjelltas) është aktive në ofrimin e shërbimeve direkte të transportit ajror të pasagjerëve me distancë të shkurtër rreth 486 milje, çdo ditë të javës (me frekuencë 10 herë në javë) duke arritur një numër prej në total prej 99 947 pasagjerësh në vit.

Duke qënë se të dyja shoqëritë janë pjesë e Star Alliance, realizojnë edhe fluturime indirekte, duke shfrytëzuar lidhjet me shoqëritë brenda këtij grupi, me pjesë tregu sipas numrit të pasagjerëve, për:

Itinerari Tiranë - Vienë.

Shoqëria ajrore Austrian Airlines AG ofron shërbimin e transportit ajror të pasagjerëve për në Vienë, linjë direkt, më një frekuencë fluturimesh prej 10 herë në javë dhe me kohë fluturimi rreth 1 orë e 40 minuta.

Gjithashtu për në destinacionin Vienë, këtë shërbim me linjë indirekt e ofrojnë edhe shoqëritë;

- o Adria Airways, destinacioni kryesor, nisur nga Tirana është Ljubjana. Destinacioni Vienë bëhet i mundur nga shoqëria Adria nëpërmjet fluturimit indirekt më ndalësë në Ljubjanë, me një kohë fluturimi rreth 4 deri në 5 orë (duke përfshirë edhe kohën e qëndrimit në aeroportin e Ljubjanës) dhe
- o Lufthansa, destinacioni kryesor, nisur nga Tirana është Mynihu. Lufthansa e ofron shërbimin e transportit të pasagjerëve në destinacionin Vienë, nëpërmjet fluturimit indirekt me ndalesë në Mynih me një kohë fluturimi rreth 5 deri në 6 orë (përfshirë këtu ndalesën në aeroportin e Mynihut).

Itinerari Tiranë-Mynih

Shoqëria ajrore Lufthansa ofron shërbimin e transportit ajror të pasagjerëve për në Mynih, linjë direkt, më një frekuencë fluturimesh prej 7 herë në javë dhe me kohë fluturimi rreth 1 orë e 50 minuta.

Gjithashtu për në destinacionin Mynih, këtë shërbim me linjë indirekt e ofrojnë edhe shoqëritë;

- o Adria Airways, destinacioni kryesor, nisur nga Tirana është Ljubjana. Destinacioni Mynih bëhet i mundur nga shoqëria Adria nëpërmjet fluturimit indirekt më ndalesë në Ljubjanë, me një kohë fluturimi rreth 4 deri në 5 orë (duke përfshirë edhe kohën e qëndrimit në aeroportin e Ljubjanës); dhe
- o Alitalia, destinacioni kryesor, nisur nga Tirana është Roma. Alitalia e ofron shërbimin e transportit të pasagjerëve në destinacionin Mynih, nëpërmjet fluturimit indirekt me ndalesë në Romë me një kohë fluturimi rreth 5 deri në 6 orë (përfshirë këtu ndalesën në aeroportin e Romës).

19. Në tregun e brendshëm të transportit ajror të pasagjerëve bëjnë pjesë rreth 12 shoqëri ajrore. Konkurrentët më të mëdhenj me pjesë të konsiderueshme janë shoqëria Belle Air (37%); Alitalia (17%), Albanian Airlines (11%); të cilët, kryejnë fluturime kryesisht në distanca të shkurtra, nëpërmjet aeroportit të vetëm në Tiranë. Në vitin 2008 u realizuan rreth 19.194 fluturime dhe rreth 1 267 041 pasagjerë.

20. Shërbimi i transportit ajror të kargos

Tregu përkatës për shërbimin e transportit të kargos, është përcaktuar si treg mbarë European, i cili përfshin transportin rrugor dhe/ose mënyra të tjera të transportit³. Duke iu referuar këtij përcaktimi të bërë nga Komisioni European në rastet analoge të shqyrtuara, në tregun e shërbimit të kargos në Shqipëri, palët:

- Deutsche Lufthansa AG nuk e ofron këtë shërbim në tregun shqiptar.
- Austria Airlines është aktive në ofrimin e këtij shërbimi, me pjesë tregu 15 % për vitin 2007 dhe rreth 12 % për vitin 2008. Xhiro e realizuar për vitin 2007 është rreth € xxxx milion .

Për këtë arsye mund të themi që ky transaksioni në kuptim të seksionit 6.3 nuk ka tregje të prekura në këtë produkt.

21. Konkurrentët në tregun e brendshëm që ofrojnë këtë shërbim janë 11 shoqëri, ku 5 më të mëdhenjtë me pjesë tregu nga (10%-32%), janë: ABC Air (32%); Turkish Air Lines (19%); Alitalia (13%); Swift Air (10%), Malev (5%) dhe 5 të tjerë me pjesë tregu nga 1%- 3% (BelleAir, Olimpik, Aegean, Albanian, Adria).
22. Pas realizimit të përqendrimit, Austrian Airlines AG mbetet një shoqëri e pavarur me seli në Austri, me një emër tregtar dhe menaxhim të ndarë nga Lufthansa. Austrian Airlines AG do të vazhdojë të ketë të drejtat e saj të trafikut ajror, licensat e veprimtarisë, avionet dhe ekuipazhin e saj, të ndjekë strategjinë e saj në përmirësimin e shërbimit me “fokus Lindjen”.
23. Përqendrimi do të sjellë një rritje të qëndrueshme të konkurrencës në treg: për Lufthansën do të sjell zgjerim të linjave, rritjen e të ardhurave etj. ndërsa Austrian Airlines, do të jetë në një pozicion që të përfitojë nga eksperiencia e Lufthansës, nga ekonomitë e shkallës, prezenca në treg dhe forca e konkurrencës e Lufthansës.
24. Përqendrimi do të gjenerojë sinergji shtesë operationale dhe rrjeti nëpërmjet optimizimit të lidhshmërisë dhe shtimit të shërbimeve direkte dhe jo direkte, duke u ofruar konsumatorëve shërbim cilësor, lehtësi në transferta nëpërmjet Frankfurtit, Mynihut, Zyrihut, Brukselit dhe Vienës. Integrimi në sistemin lidhës shumë nyjesh në Lufthansa Grup do të bëjë rrjetin e linjave më tërheqës për klientët e të dy shoqërive dhe do t’u sigurojë atyre lidhjen me Vienën.
25. Transaksioni do të çojë në uljen e kostove nëpërmjet optimizimit të përdorimit të avionit, sigurimit, financimit, shitjeve dhe marketingut. Lufthansa parashikon që sinergjitë e krijuara nëpërmjet transaksionit të propozuar do të shkojnë deri në € xxxx milion për vit.

³ Case N0 Comp/M.3280 –Air France/KLM etj

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, shkronjat d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit në shoqërinë Austrian Airlines AG nga shoqëria Deutsche Lufthansa AG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot me datë 23.04.2009

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 109, Datë 04.05.2009

**“Për rekomandim mbi rishikimin e pikës 1 të Vendimit të Këshillit
Administrativ të ISKSH-së Nr.50, datë 12.12.2008”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Z. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.05.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësim i Vendimit të Këshillit Administrativ të ISKSH-së Nr. 50 datë 12.12.2008 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, farmacive dhe agjencive farmaceutike, depove importuese, distributoreve të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së – QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2009”

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, gërma “f”, neni 69 pika 1, gërma (a) dhe neni 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Ankesës Nr.23/01, datë 23.01.2009 të Sindikatës së Pavarur të Farmacistëve të Rrjetit të Hapur;

Relacionit të Sekretares së Përgjithshme;

Pretendimeve të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor në seancën konsultative me Komisionin e Konkurrencës me datë 23 prill 2009;

V Ë R E N S E:

1. Vendimi Nr.50 datë 12.12.2008 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, Farmacive dhe Agjencive farmaceutike, depove importuese, distributore të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së – QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2009”, në pikën 1 shprehet: “Miratimin e kontratës tip F/2009 sipas formatit dhe përmbajtjes që i bashkëngjitet këtij vendimi, me ndryshimin e mëposhtëm të propozuar nga KA “Vendosja e vlerës limit të rimbursimit mujor

të çmimit të barnave, në farmaci dhe A/farmaceutike të kontraktuara në masën 1 500 000 lekë. Mbi këtë limit farmacistë, a/farmaceutike mund ti rimburohet deri në 2% të kësaj vlere”.

Nga seanca konsultative me përfaqësues të ISKSH-se rezultoi se kriteri i shprehur në pikën 1 të Vendimit Nr.50 datë 12.12.2008 ka patur si qëllim mbrojtjen e konkurrencës së ndershme në treg.

2. Në vlerësim të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, në nenin 69, pika 1/a dhe 70, Vendimi nr.50 datë 12.12.2008 i ISKSH-se, sjell kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregimin e barnave të rimbursueshme.
3. Ky kufizim sasiore në masën prej 1.500.000 lekë në muaj, plus 2%, i parashikuar në pikën 12 të këtij kapitulli, sjell një kufizim të detyrimeve specifike (pika 5) në kontratën e farmaceutike, pasi në rastet e plotësimit të limitit të caktuar, farmacia nuk do të ofrojë shërbimin e dhënies së barnave, duke kufizuar në këtë mënyrë zgjedhjen konsumatore.
4. Këshilli Administrativ dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, duhet që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që ndikon në konkurrencën në treg, në kuptim të neneve 69 dhe 70 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe sipas udhëzuesit “Për vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën”, miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 68, datë 24.12.2007.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 24 gërma (f), 69 pika 1, gërma (a) dhe nenit 70, të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit;

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, rishikimin e pikës 1 të Vendimit të tij nr.50, datë 12.12.2008 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, Farmaceutike dhe Agjencive farmaceutike, depove importuese, distributore të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së – QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2009”;
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm t’ua komunikojë këtë vendim organeve përkatëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

()

()

()

()

Zv/Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 110, Datë 15.05.2009

Për një rekomandim mbi projekt-ligjin “Për ofertat publike të titujve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|---|--------------------------|------------|
| • | Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • | Z. Lush Përpali | zv/kryetar |
| • | Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| • | Z. Koço Broka | Anëtar |
| • | Znj. Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 15.05.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësimi i Projekt-ligjit “Për ofertat publike të titujve”.

Baza ligjore: Neni 24, germa f, dhe neni 69, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Shkresës nr. 3387 Prot., datë 10.04.2009 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

V Ë R E N S E:

Me anë të shkresës nr. 3387 Prot., datë 10.04.2009 Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës i kërkon Autoritetit të Konkurrencës vlerësimin e tij për projekt-ligjin “Për ofertat publike të titujve”.

Në bazë të nenit 69 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që rrjedh nga projekt-aktet normative.

Oferta ka për synim fitimin e kontrollit mbi shoqërinë objekt i ofertës, në këtë mënyrë vetë procesi i blerjes së ofertës kërkon norma rregulluese, krahas atyre që parashikohen në dispozitat për grupimet në nenet nga 206 deri në 212 të Ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Komisioni i Konkurrencës është i mendimit se nëpërmjet këtij Projekt-ligji synohet të bëhet një përcaktim i qartë i rregullave që lidhen me kushtet dhe procedurat për ofertat publike të blerjes së titujve të emetuar nga një shoqëri aksionare, duke kërkuar që ofertat të jenë publike dhe transparente dhe duke monitoruar dhe mbikëqyrur këtë proces nga ana e Autoritetit të Mbikëqytjes Financiare.

Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, përqendrimet e ndërmarrjeve që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën një të këtij neni, njoftohen në Autoritetin e Konkurrencës për të marrë autorizim.

Si pasojë e përfitimit të Kontrollit që parashikohet të ndodhë si rezultat i ofertave publike të titujve, mund të krijohet një përqendrim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f, nenin 69, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

Ti rekomandojë METE të shtojë pas pikës 3 të nenit 7 “Dokumenti i ofertës” të projekt-ligjit “Për ofertat publike të titujve”, një dispozitë me përmbajtjen si vijon:

“Kur nga përftimi i kontrollit që parashikohet të ndodhë si rezultat i publikimit të dokumentit të ofertës, mund të krijohet një përqendrim në kuptim të nenit 12, pika 1, të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ky përqendrim duhet të njoftohet në Autoritetin e Konkurrencës, për të marrë autorizim, sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 111, Datë 15.05.2009

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transaksionit të shitblerjes së 76 % të aksioneve të OSSH SH.A nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës tek shoqëria Cez a.s.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| • Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • Z. Lush Përpali | zv/kryetar |
| • Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| • Z. Koço Broka | Anëtar |
| • Znj. Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 15.05.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 76 % të aksioneve të shoqërisë OSSH SH.A nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te shoqëria Cez s.a

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit për përqendrimin e realizuar (përfitim kontrolli) të shoqërisë Cez a.s tek shoqëria OSSH nëpërmjet blerjes së 76 % të aksioneve dhe relacionit të Sekretares së Përgjithshme,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe Përqendrimi

Transaksioni i blerjes së 76 % të aksioneve te shoqërisë OSSH SH.A nga Shoqëria Cez a.s. është realizuar nëpërmjet “Marrëveshjes për blerje aksionesh” e datës 11 Mars 2009, nënshkruar

nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, (METE) dhe shoqëria Cez a.s.

Marrëveshja e datës 11 Mars 2009 e përqendrimit të synuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 4 të kontratës së lidhur ndërmjet palëve është miratuar¹ nga Parlamenti Shqiptar me datë 23 Prill 2009.

Përqëndrimi i realizuar është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresën Nr. 133 Prot, me datë 18 Mars 2009, brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 12 pika 2 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Transaksioni i njoftuar paraqitet si përfitim kontrolli i drejtpërdrejtë ku OSSH SH.A do kontrollohet nga aksioneri mazhoritar Cez a.s si zotërues i 76% të kapitalit aksioner me të drejtë vote. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si përfaqësues i shtetit shqiptar do të zotërojë 24 % të aksioneve.

Transaksioni kryhet në përputhje me Ligjin Nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”; Ligjin Nr. 9889, datë 20.03.2008 “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 835 datë 11 Qershor 2008.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b dhe 10/2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, është përfitim i kontrollit të vetëm.

Autoriteti i Konkurrencës ka zhvilluar një hetim të përgjithshëm në sektorin e energjisë dhe është shprehur me Vendim Komisioni Nr. 90, datë 07.10.2008 “Për disa rekomandime për liberalizimin dhe rritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike“. Komisioni i Konkurrencës nëpërmjet këtij vendimi i ka rekomanduar OSSH sh.a. “që për çdo rast të sigurojë aksesin në rrjet të të gjithë konsumatorëve në përputhje me rregullat e sjelljes së operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg dhe që të marrë të gjitha masat për të përmbushur detyrimet e kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike të lidhur me prodhuesit e vegjël”.

II. Palët në transaksion

a. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, (METE) aksioner 100% i kapitalit aksionar dhe njëkohësisht shitës i pjesës 76% të kapitalit me të drejtë vote në shoqërinë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH SHA), në cilësinë e shitësit. OSSH SH.A është një shoqëri me kapital 100% shtetëror, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me numër rregjistri K72410014H, me seli në adresën “Blloku Vasil Shanto”, Tiranë. OSSH është pjesë e Sistemit Elektroenergjetik të Shqipërisë të krijuar në vitin 1957. OSSH SH.A është operatori i vetëm publik që vepron në tregun e brendshëm të shpërndarjes së energjisë elektrike.

b. Shoqëria CEZ a.s, në cilësinë e blerësit, është një shoqëri aksionere, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit çek, me seli në Pragë 4, Duhova 2/1444, 14053, Çeki, e regjistruar ne Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Pragë, me numër dosje 1581 “CEZ a.s”².

Shoqëria CEZ a.s, është prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në Republikën Çeke, të krijuar qysh në vitin 1992 nga Fondi i Pronësisë Kombëtare dhe është shoqëria mëmë dhe kryesore e CEZ Group. CEZ Group është krijuar në vitin 2003, nga bashkimi i ČEZ, a. s. me pesë kompani shpërndarëse rajonale çeke.

¹ Ky miratim së bashku me Autorizimin e përqendrimit nga Autoriteti i Konkurrencës, është kusht përmbushës për relizimin e transaksionit sipas Nenit 4 paragrafi 3 i Marrëveshjes për blerjen e aksioneve, date 11.03.2009.

² Burimi Ekstrakt i Regjistrin Tregtar për shoqërinë CEZ A.S, datë 17.03.2009 dhe Formulari i thjeshtuar i njofimit të përqendrimit.

III. Xhiro e ndërmarrjeve

- a. Xhiro në **tregun ndërkombëtar** e realizuar nga shoqëria CEZ a.s³, është xxxxxxxx CZK⁴ = xxxxxxxx Lekë; dhe
- b. Xhiro në **tregun e brendshëm** e realizuar nga shoqëria OSSH sh.a⁵, është xxxxxxxx Lekë.

IV. Tregu përkatës

Në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet për përqendrimet dhe sipas veprimtarisë që kryejnë palët pjesëmarrëse në këtë transaksion **tregu përkatës produkti** do të konsiderojmë:

- (i) **shpërndarjen e energjisë elektrike dhe;**
- (ii) **furnizimin/shitjen e energjisë elektrike.**

VI.2. **Tregu përkatës gjeografik:** Për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet **tregu i brendshëm/territori i Republikës së Shqipërisë.**

Sistemi i shpërndarjes është i ndarë në 10 qendra rajonale shërbimi, të cilat shërbejnë për tensione me voltazh të ulët dhe të mesëm dhe 5 zona me tension me voltazh të lartë. Shumica e zonave janë të ndara në katër dhe pesë agjensi. Numri i agjensive shkon deri në 39.

Megjithëse palët pjesëmarrëse në përqendrim ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin nivel tregu të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, veçojmë që në tregun e brendshëm, vetëm OSSH është e pranishme aktualisht.

V. Mbrojtja e konsumatorit dhe kuadri ligjor

Veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike rregullohen nga Ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i cili përcakton të drejtat dhe detyrat e personave fizikë dhe juridikë, të administratës publike të përfshirë në këtë sektor, si dhe procedurat për përzgjedhjen dhe zhvillimin e një modeli tregu dhe të rregullave të funksionimit të tij.

Institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas këtij ligji është Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), që ndër të tjera, përcakton dhe rregullon tarifën e shitjes me shumicë dhe me pakicë, afatet dhe kushtet e shërbimit të energjisë elektrike, të propozuara nga i licensuari ose i rishikon ato në përputhje me rrethanat; garanton që programet e investimeve dhe kontratat e blerjeve të energjisë elektrike të jenë në përputhje me parimet e planifikimit me koston më të ulët; mbron interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike për tarifën, duke garantuar që këto tarifa janë në përputhje me parimet e vendosjes së tarifave; ruan ekuilibrin ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit, investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në sektorin e energjisë elektrike; nxit konkurrencën në sektorin e energjisë elektrike; kontrollon nëse i licensuari, që ofron shërbimin me energji elektrike për konsumatorët, respekton kushtet e kontratës ose siguron shërbime, sipas standardeve të vendosura në license ose në ndonjë rregullore të miratuar nga ERE-ja etj.

³ Burimi: Pasqyrat Financiare të Audituar dhe Raporti i Audituesve të Pavarur për vitin 2008

⁴ Burimi: Faqja e internetit www.xe.com, 1 CZK = 4.93 Lekë

⁵ Burimi: Pasqyrat Financiare për vitin 2008

Te gjitha marrëveshjet ne tregun e parregulluar⁶ jane objekt monitorimi nga ERE per te siguruar funksionimin siç duhet te tregut dhe se pjesmarresit e tregut nuk ushtrojne fuqi tregu ose ndjekin praktika te pandershme tregtare.

ERE ka vendosur qe periudha 1 Janar 2009 - 31 Dhjetor 2009 të jetë një periudhë tranzitore gjatë së cilës nuk do të ketë ndryshim në tarifatat ekzistuese⁷, te percaktuara me Vendimin e saj Nr.21, date 14 shkurt 2008. Në këtë mënyrë do t'i jepet mundësia investitorit të vlerësojë situatën brenda OSSH-së dhe të përgatisë aplikimin për rishikimin e këtyre tarifave të reja jo me vonë se 30 shtator 2009. Tarifatat e reja do të jenë efektive duke filluar nga data 01 janar 2010. Periudhat vijuese te rregullimit do të jenë nga 3 deri në 5 vjet.

VI. Analiza e konkurrencës

Shoqëria OSSH SH.A ka pozita monopol në tregun e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike dhe ky transaksion nuk ndryshon strukturën e tregut, por vetëm mënyrën e operimit të këtij tregu nga një monopol të zotëruar nga shteti te një investitor privat.

Tregu i shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike është një treg i rregulluar nën mbikqyrjen e Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, i cili ka kompetencë të miratojë tarifatat dhe metodologjitë e llogaritjes së çmimit për konsumatorët finalë⁸.

Enti Rregullator të Energjisë Elektrike në bazë të nenit 69 të ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës duhet të kërkojë vlerësimin ligjor pranë këtij institucioni përpara miratimit të metodologjive të tarifave dhe të akteve të tjera rregullatore që mund të prekin tregun përkatës.

Në kuptim të nenit 56, pika 1 të ligjit nr 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar impaktin që mund të sjellë ky përqëndrim në treg nëse shfaq shenja të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese.

Si konkluzion, transaksioni i njoftuar nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të shoqërisë pas përqëndrimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, nenit 69 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

⁶ Në bazë të nenit 4.13 “Modeli shqiptar i tregut” Marrëveshjet e parregulluara janë:

- Ndermjet Furnizuesve te Kualifikuar dhe Klienteve te Kualifikuar;
- Ndermjet PVE-ve, PPE-ve, Furnizuesve te Kualifikuar dhe Tregtuesve;
- Ndermjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe PPE-ve, PVE-ve, Furnizuesve te Kualifikuar dhe Tregtuesve;
- Ndermjet OSSH-se dhe Tregtuesve, Furnizuesve te Kualifikuar, PPE-ve dhe PVE-ve per energjine e nevojshme per te mbuluar humbjet ne sistemin e shperndarjes.

⁷ Burimi : Deklarata rregullatore e miratuar në datë , 03.03.2009.

⁸ E parashikuar edhe në Direktivën 2003/54/EC

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 76 % të aksioneve të OSSH SH.A nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës tek shoqëria Cez a.s.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për monitorimin e drejtëpërdrejtë të tregut të energjisë elektrike.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve pjesëmarrëse në trasaksion si dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

()

Zv/Kryetar

()

Anëtar

()

Anëtar

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 112, Datë 15.05.2009

Për kërkim të dhënash nga Shoqëria “Albania AirLine MAK Shpk”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|---|--------------------------|------------|
| • | Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • | Z. Lush Përpali | zv/kryetar |
| • | Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| • | Z. Koço Broka | Anëtar |
| • | Znj. Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 15.05.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Kërkim i të dhënave nga Shoqëria Albania AirLines MAK Shpk.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti neni 33 “Detyrimi për të njoftuar”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe informacionit të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut në lidhje me procedurën e kontrollit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine MAK Shpk. nga shoqëria Advanced Construction Group shpk, e cila është hapur me Vendim të Komisionit të Konkurrencës Nr. 100, datë 03.02.2009.

V Ë R E N S E:

- Me shkresën Nr. 485/6 Prot, datë 04.02.2009, shoqëria Albania AirLines MAK Shpk është njoftuar në lidhje me hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet “Shitblerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine MAK Shpk nga shoqëria Advanced Construction Group shpk”, me Vendimi të Komisionit Nr. 100, datë 03.02.2009,
- Me shkresën Nr. 485/7 Prot, datë 24.03.2009, Sekretariati i ka bërë me dije shoqërinë Albania AirLines MAK Shpk, penalitetet që rrjedhin nga mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor.

- Në përfundim, mos-sigurimi i informacionit nga ana e shoqërisë Albania AirLines MAK Shpk. është bërë pengesë për vazhdimin e procedurës së kontrollit të këtij përqendrimit.
- Nëse të dhënat jepen jo të sakta, jo të plota ose jashtë afatit kohor mund të merret masa e gjobës deri në 1 % të xhiros totale të vitit paraardhës financiar sipas nenit 73 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2005 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d) dhe nenit 33, shkronja 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

1. T’i kërkojë Shoqërisë Albania AirLines MAK Shpk, plotësimin e formularit të njoftimit të përqendrimit sipas udhëzimit mbi formën e njoftimit të përqendrimit (bashkëlidhur këtij vendimi, formulari dhe udhëzimi), brenda 15 ditësh nga data e njoftimit.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 113, Datë 19.05.2009

Për

“Ndalimin e marrëveshjes në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit midis ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|---|--------------------------|---------|
| • | Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • | Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| • | Z. Koço Broka | Anëtar |
| • | Znj. Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 19.05.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit

Baza ligjore: Ligji nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 4, pika 1, germa a), b) dhe c), neni 24, shkronja d), dhe neni 45, pika 1.

Komisioni i Konkurrencës, pasi shqyrtoi Raportin e grupit të punës për hetimin e thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, të hapur me Vendimin Nr. 88 datë 02.10.2008 të Komisionit të Konkurrencës, dhe relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm:

K O N S T A T O I :

Në raportin e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës mbi hetimin e thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, rezulton se dy nga ndërmarrjet nën hetim “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a”:

1. Mbajnë të dhëna të plota mbi importet e kryera nga secila prej ndërmarrjeve respektive;
2. Kryejnë blerje të përbashkëta, por deklarimi në doganë bëhet në emër të një ndërmarrje;
3. Ndajnë shpenzimet e doganës, shpenzimet e transportit dhe shpenzime të tjera në masën 50 % me 50%.
4. Mbajnë të dhëna të sakta mbi detyrimet dypalëshe (arkëtimet dhe gjendjet debitore) të njëri tjetrit, sasinë e grurit të blerë dhe shpenzimet e zhdoganimit.

5. Zotërojnë së bashku 50.24% të tregut të importit të grurit, 34.67 % të tregut të shitjes së grurit, 50% të tregut të prodhimit të miellit (25% Atlas dhe 25% Bloja), teknologji dhe kapacitete të larta përpunimi, duke u bërë një faktor i fuqishëm që kufizon konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.
6. Kanë fuqi tregu për të shkaktuar kufizime të konkurrencës. Shkalla e përqendrimit të këtyre dy ndërmarrjeve është e lartë, fuqia kundërvepruese e të gjithë konkurrentëve të tjerë është me e vogël se e ndërmarrjeve Bloja sh.a dhe Atlas sh.a, fuqia kundërvepruese e klientëve (mullinj të vegjël dhe prodhues buke) është e vogël.
7. Sjellja e ndërmarrjeve në treg duhet të reflektojë konkurrencën e lirë dhe efektive.

Sa më lart, nga analiza e sjelljes së këtyre ndërmarrjeve në treg, vërtetohet ekzistenca e një praktike të bashkërenduar ndërmjet tyre, e cila në kuptim të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 3 pika 4 konsiderohet marrëveshje.

Bazuar në nenin 4 të Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kjo marrëveshje konsiderohet marrëveshje e ndaluar, dhe bie në kundërshtim me pikën 1 gërmat a), b) dhe c) të këtij neni, pasi cakton në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes së miellit, kufizon dhe kontrollon tregun e shitjes së grurit dhe prodhimit të miellit, si dhe ndan tregun e shitjes së miellit, duke kufizuar në mënyrë të ndjeshme konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d dhe nenin 45, pika 1 të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Ndalimin e marrëveshjes në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit midis ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a si marrëveshje e ndaluar në kuptim të nenin 4 të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

()

()

()

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 114, Datë 26.05.2009

Për kërkim të dhënash nga Shoqëria “Albania AirLine MAK Shpk”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Z. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.05.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësimi i ankesave të Shoqërive të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) e f), dhe neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Grupit të Punës “Për trajtimin e ankesave të Shoqërive të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

V Ë R E N S E:

1. Procedura elektronike e prokurimit me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me subjekte private te objekteve te Kryeministrit, Ministrive dhe institucioneve ne varësi te tyre”, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor “Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Brendshme”, rregullohet nga Ligji nr. 9643, dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
2. Në ankesat e tyre SHRSF-të pretendojnë së në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe kërkesave për kualifikim, është shkelur legjislacioni mbi prokurimin publik.
3. Agjencia e Prokurimit Publik, ka për kompetencë shqyrtimin administrativ të ankesave me qëllim evidentimin e shkeljeve të ligjit të prokurimeve dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Këtë kompetencë të saj APP e ka ushtruar me marrjen e vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, objekt ankimi, me anë

të shkresës nr. 4471/5 prot, datë 02.04.2009. Pas marrjes së këtij vendimi të APP-së, Autoriteti Kontraktor ka filluar një procedurë të re prokurimi me të njëjtin objekt.

4. Parë në këndvështrimin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në të dy procedurat e prokurimit u vu re ndarja e kontratës në lote në nivel qarku.
5. Ndarja e kontratës në lote në nivel qarku realizon bashkimin e kërkesës midis autoriteteve kontraktore që nuk kanë madhësi të krahasueshme dhe për rrjedhojë edhe oferta kërkohet në grup duke bashkuar operatorët ekonomikë ofertues të pa barabartë dhe jo të bashkë matshëm. Kjo metodë e aplikuar nuk u jep mundësi operatorëve ekonomikë që të paraqesin ofertë individuale, por i detyron ata që të marrin pjesë në tender vetëm me bashkim, duke sjellë kufizim të konkurrencës dhe duke penguar operatorët ekonomikë të hyjnë në këto procedura si ofertues individual. Kjo mënyrë e ndarjes në lote të kontratës përbën një barrierë hyrëse për në tregun e prokurimit të shërbimit dhe ruajtjes së sigurisë fizike në kuptim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë autoritetit kontraktor ”Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurimeve të Përqendruara” pranë Ministrisë së Brendshme, të rrisë numrin e loteve të kontratës publike me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me subjekte private të objekteve të Kryeministrisë, Ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre” me qëllim mundësimin e paraqitjes së kërkesave të grupuara sipas madhësisë të krahasueshme të autoriteteve kontraktore me madhësinë e ofertave individuale nga operatorët ekonomikë. Në këtë mënyrë mundësohet rritja e konkurrencës midis operatorve që plotësojnë nivelet respektive të kërkesës.
2. T’i rekomandojë Agjencisë së Prokurimit Publik që në varësi të natyrës së kontratës që prokurohet, t’ju propozojë autoriteteve kontraktore ndarjen e kontratave në lote/nën-lote në mënyrë të tillë që të mundësohet një pjesëmarrje sa më e gjerë e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimeve publike duke siguruar një përdorim sa më të mirë të fondeve publike, nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë sipas madhësisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme në këto procedura, si dhe nxitjen e konkurrencës midis tyre.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për t’ia komunikuar këtë vendim palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

()

()

()

()

Zv/Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 115, Datë 26.05.2009

**Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për funksionimin e
 Autoritetit të Konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Z. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.05.2009, në mbështetje të nenit 24, germa “c” dhe nenit 27 të Rregullores “Për Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

Në Rregulloren “Për Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, miratuar me VKK Nr. 58 datë 15. 10. 2007, të bëhen disa shtesa, sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali
 (_____)

Zv/Kryetar

Servete Gruda
 (_____)

Anëtar

Rezana Konomi
 (_____)

Anëtar

Koço Broka
 (_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

**PËR
DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR
FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS”**

Neni 1

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me përmbajtje:

“Neni 12 /1

Arsyetimi dhe botimi i vendimeve

Vendimet e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, jepen të arsyetuara dhe jo më vonë se 15 ditë nga marrja e tij në mbledhjen përkatëse të Komisionit.

Në rast se gjatë procesit të votimit ka vota kundër, anëtari i Komisionit e evidenton atë në pjesën e nënshkrimit të vendimit, duke i shtuar nënshkrimit të tij dhe shënimin pro/kundër.

Vendimet e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, së bashku me mendimin e pakicës të argumentuar, nëse ka, botohen në Buletinin Zyrtar të vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës.”

Neni 2

Në Nenin 22 “Grupet e Punës”, pika 3 ndryshohet me përmbajtjen vijuese, si dhe shtohen pikat 4 dhe 5:

- “3. Grupi i Punës në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive përcakton metodologjinë dhe matricën e veprimeve, të cilat i bashkëngjiten proces-verbalit të mbledhjes së Grupit të Punës. Miratimi i relacioneve të mbledhjeve të rëndësishme të Grupit të Punës, si dhe i Raportit përfundimtar të fazës Hetimore, realizohet me konsensus, ose shumicë votash, (në se rezulton e nevojshme), në mbledhjet konkluduese të Grupin të Punës, për të cilat mbahet gjithmonë edhe një proces-verbal. Në pjesët ku nuk mund të ketë konsensus mes anëtarëve të Grupit, cilësohet anëtari mos-miratues, ndërsa mendimi/et i pakicës pasqyrohet në shënimet fundore të faqes.
4. Raporti së bashku me dosjen hetimore i përcillet Sekretarit të Përgjithshëm. Ky i fundit paraprakisht u kërkon mendim lidhur me Raportin edhe Drejtorëve të Drejtorive (përfshijtur ata të cilët kanë qenë vetë në përbërje të Grupit hetimor të Punës) të cilët e japin atë me shkrim sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se 15 ditë nga dita që kanë marrë dijëni për raportin.
5. Sekretari Përgjithshëm, me marrjen e raportit nga ana e Grupit të Punës:
 - a) Në rast se i gjen të bazuara procedurat dhe konkluzionet e Raportit e dërgon atë, së bashku më relacionin përkatës, për shqyrtim në Komision, brenda 5 ditësh pune dhe e relaton përpara Komisionit së bashku me Kryetarin e Grupit të Punës.;
 - b) Në rast se Sekretari i Përgjithshëm nuk krijon bindje mbi faktet, procedurat dhe konkluzionet e Raportit të Hetimit, atëherë ai mund ta kthejë vetëm një herë për rishqyrtim pranë Grupit të Punës, bashkë me vërejtjet dhe sugjerimet e tij për Raportin.
 - c) Kur Grupi i Punës ose shumica e anëtarëve të tij, edhe pas rikthimit të Raportit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm nuk bien dakord me vërejtjet dhe propozimet, përgatit kundër-argumentet ndaj vërejtjeve të Sekretarit të Përgjithshëm. Në këtë rast Sekretari i Përgjithshëm e përcjellë Raportin së bashku me dosjen hetimore në Komision. Mbrojtja në këtë rast përpara Komisionit do të bëhet nga vetë Grupi i Punës ndërsa Sekretari i Përgjithshëm sqaron vërejtjet e tij për raportin.

Neni 3

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

Neni 26/1

Ankesat, kërkesat dhe njoftimet nga personat që do të paraqiten pranë Autoritetit të Konkurrencës, duhet të plotësojnë formularin tip me shkrim të ankesës siç parashikohet në këtë rregullore. Ata që nuk janë në gjendje të paraqesin një ankesë me shkrim, apo nuk dëshirojnë të bëjnë një gjë të tillë, mund ta paraqesin atë me gojë. Në këtë rast punonjësi i Protokollit do të marrë shënim ankesën, kërkesën apo njoftimin e bërë, do të bëjë shënim se personi që e paraqet atë nuk dëshiron ta depozitojë formalisht dhe do ta firmosë vetë së bashku me një person tjetër të pranishëm nga institucioni.

Në rastet kur Autoritetit të Konkurrencës ose punonjësve të institucionit u paraqiten ankesa, kërkesa apo njoftime me shkrim, që dorëzohen dorazi apo me postë elektronike për çështje që janë në juridiksionin e institucionit, ato duhet të regjistrohen në librin përkatës të protokollit.

Autoriteti i Konkurrencës, merr në shqyrtim edhe ankesat anonime për çështje që janë në juridiksionin e institucionit. Këto ankesa regjistrohen në librin e protokollit.

Në çdo rast, zyrtari i Autoritetit të Konkurrencës që vihet në dijeni të një ankese me shkrim apo me gojë, të ardhur në çdo formë është i detyruar të ruajë konfidencialitetin mbi identitetin e personit që ka bërë ankimin dhe mbi përmbajtjen e ankimit sipas detyrimit të parashikuar në nenin 30 të ligjit 9121 “për mbrojtjen e Konkurrencës”.

Neni 4

Pas nenit 26/1 shtohet neni 26/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 26/2

Formulari Tip i Ankesës

Formulari tip i Ankesës, që duhet të plotësohet, në rastet kur personi paraqitet në Autoritetin e Konkurrencës për një ankim, ose njoftim, duhet të firmoset dhe depozitohet nga personi që e bën ankimin, ose përfaqësuesi ligjor i tij dhe mund të përmbajë:

- 1. Fillimisht specifikimin e ankuesit në se dëshiron:
 - a. të identifikohet, apo
 - b. të mbetet anonim,
 si dhe të shënojë datën e plotësimit, ose të dorëzimit të formularit;
- 1/a. Identitetin, vendbanimin, ose adresën e punës të ankuesit, të cilit i cenohen të drejtat dhe liritë e tij, si dhe të dhëna kontakti të telefonit, faksit ose adresës elektronike (e-mail), vetëm në rast se ankuesi i përmbahet gërmës a, të pikës 1 të këtij neni;
- 2. Pretendimet për kufizimet ose shkeljet e dyshuara të konkurrencës ndaj tij, ose subjekteve të tjera;
- 3. Ndërmarrjen ose institucionin të cilin e dyshon si shkelëse të ligjit dhe ndaj të cilit ankohet ose sinjalizon;
- 4. Përshkrimi i fakteve të cilave u referohet;
- 5. Renditjen e provave të shkeljes së dyshuar që ai disponon;

- 6. Institucione të tjera publike të cilat janë vënë në dijeni që më parë për çështjen objekt-ankese;
- 7. Çdo lloj shkrese, origjinale, ose fotokopje, në të cilën e mbështet ankesën, kërkesën apo njoftimin;

Një formular - tip Ankese gjendet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Konkurrencës. ”

Neni 5

Pas nenit 26/2 shtohet neni 26/3 me këtë përmbajtje:

Neni 26/3

Trajtimi i ankesave

Brenda 24 orëve nga koha e mbërritjes në institucion duhet të bëhet shpërndarja e kërkesave, ankesave apo njoftimeve nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili shënon drejtorinë apo sektorin, në kompetencën e të cilit është ndjekja e çështjes.

Sekretari i Përgjithshëm vlerëson nëse kërkesa është në juridiksionin e Autoritetit të Konkurrencës apo jo dhe njofton Komisionin mbi këtë vlerësim.

Pala/Palët që kanë bërë ankesën apo kërkesën duhet të njoftohet nga Sekretari i Përgjithshëm mbi trajtimin e saj, jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes dijeni nga Autoriteti. Në mbyllje të procedurës Autoriteti do të njoftojë palën e interesuar mbi rezultatet e procedimit administrativ të ankesës, kërkesës apo njoftimit në zbatim të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 116, Datë 29.05.2009

Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes midis “Tirana International Airport” Shpk dhe “AIR BP Albania” Sh.a
“Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë, si dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Z. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.05.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Përjashtimin nga ndalimi i marrëveshjes së lidhur midis “Tirana Airport Partners” Sh.p.k dhe “Air BP” Sh.a

Baza ligjore: Ligji Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 6, neni 24, shkronja d, neni 49 dhe neni 50 pika 1.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit “Për përjashtimin nga ndalimi i marrëveshjes midis TIA dhe Air BP”,

V Ë R E N S E:

Në datën 27.02.2009 Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 6 dhe 49 të Ligjit ka marrë njoftimin nga “Air BP” Sh.a dhe “TIA” (Tirana International Airport) Sh.p.k për përjashtimin e marrëveshjes “Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza” lidhur midis tyre më 24.02.2009.

I. Palët në marrëveshje

- **Tirana International Airport Sh.p.k** (TIA, këtu e vijim dhe më parë e njohur si Tirana Airport Partners Shpk), një shoqëri e krijuar sipas ligjshmërisë së Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me Vendimin nr. 32147, datë 20.09.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën “Godina e Administratës” ne Aeroportin Ndërkombëtar te Tiranës. TIA zotëron me anë të koncesionit dhe ushtron veprimtarinë e saj në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” Tiranë (“Aeroporti” në bazë të Ligjit nr. 9312 datë 11.11.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit lidhur midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Airport Partners Shpk për ndërtim, vënien në punë, operimin, mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza” Tiranë dhe për dhënien e stimujve Shoqërisë Koncesionare”.
- **AIR BP Sh.a** (Këtu e vijim ABP) është një shoqëri e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar me anë të vendimit nr. 22194, datë 27.10.1999 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, me seli në adresën: Gurten Business Centre, Rruga e Kavajës, nr. 116, zyra nr. 113, Tirane. ABP Albania zotëron dhe menaxhon një depozitë karburanti pranë aeroportit sipas kushteve të një marrëveshje të veçantë koncesioni të lidhur midis Tirana Airport Partners Shpk dhe ABP, të datës 28 Prill 2006. ABP operon në fushën e tregtisë së karburanteve për avionë.

II. Përshkrimi i marrëveshjes

TIA dhe ABP kanë rënë dakord me anë të kësaj marrëveshje, që ABP të projektojë dhe të ndërtojë një depozitë karburanti dhe një strukturë të re tjetër brenda Aeroportit me qëllim dërgimin në aeroplan të karburantit si dhe marrjen me qira të zonës në të cilën do të vendoset impianti i ri.

Pra, ABP është nën-kontraktore e TIA-së për ndërtimin dhe vënien në punë të impiantit të ri të karburantit, për depozitim e karburantit, ofrimin e shërbimit të shitjes dhe të dërgimit në avionë të karburantit (into plane service) për operatorët ajrorë në Aeroportin Ndërkombëtarë të Tiranës.

Air BP, sipas marrëveshjes do të jetë zotëruesi dhe operatori i impiantit të depozitimit të karburantit në Aeroport dhe gjithashtu furnizuesi i vetëm i shërbimit (into-plane service) të karburantit në avione.

Sipas kësaj marrëveshje (pika 3.7) TIA nuk do të lejojë asnjë person tjetër, firmë apo shoqëri, për të depozituar karburant për avion ose produkte të këmbësorë në avion brenda Aeroportit deri më 31 Dhjetor 2014, ose deri atëherë kur numri i pasagjerëve që përdorin Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës të tejkalojë dy milion në një vit kalendarik, duke i dhënë ABP të drejtën ekskluzive të shërbimit të furnizimit në avion (into plane service).

Marrëveshja (ne pikën 4.2) lejon palët e treta, të cilave u është dhënë leje për të hyrë në aeroport nga TIA të depozitojnë karburantin e tyre në impiantin e depozitimit, me kusht që kërkesa vjetore për karburant për avione të palës së tretë ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë për vitin në vazhdim të paktën 25% e kërkesës së përgjithshme për karburant për avionë në aeroport¹, si dhe plotësimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë të kërkuara nga parametrat ndërkombëtarë në lidhje me këto shërbime (te njëjta me ABP).

¹ Nëse asnjë Pale e Trete nuk arrin nivelin 25% të kërkesës ABP dhe TIA do të vlerësojnë (duke vepruar arsyeshëm) uljen e këtij niveli.

III. Tregu përkatës

Marrëveshja e njoftuar ka për qëllim të sigurojë mundësinë e depozitimit dhe të shpërndarjes të karburantit për avionë në avionë, për kompanitë ajrore që operojnë në aeroportin e Rinasit. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”. Ky përkufizim përfshin dy komponentët e tregut përkatës:

- a. Tregu i produkteve
- b. Tregu gjeografik.

III.1. Tregu përkatës i produktit

Treg përkatës i produktit është tregu i depozitimit, tregtimit dhe shërbimit të furnizimit të karburantit për avionë në avionë.

Ne baze të marrëveshjes do të kemi tre tregje:

- a) Tregu për sigurimin e depozitimit të karburantit për avionë.

Bazuar në marrëveshje, Air BP është firma e vetme e cila pranon të bëjë investimin për sa i përket ndërtimit të një impianti të ri për karburant, e vlerësuar nga ABP rreth 2 milion dollarë.

- b) Tregu i tregtimit të karburantit për avionë.

Subjekte të pajisura me leje për tregtimin e karburantit të llojit c; kat.3/c (kategori e klasifikuar si – lende djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktive – kerozene) , në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për naftën, gazin dhe nënproduktet, neni 10 janë: Air BP Albania Sh.a; ARMO Sh.a; MEICO Sh.a; Global Petroleum Albania Sh.a; Mamidoil Sh.a dhe Albania Airlines & Jet Fuel Supply Sh.a.

- c) Tregu i shërbimit të furnizimit në avione

Nuk ka asnjë firmë tjetër që të mundësoi këtë shërbim, në baze të marrëveshjes si edhe në baze të direktives 96/67 e Komisionit Europian e 15.10.1996 “THE EUROPIAN GROUND HANDLING DIRECTIVE“. Direktiva mbi asistencën në tokë.

Si rrjedhojë TIA mund të ketë vetëm një furnizues të karburantit dhe të shërbimit të furnizimit të avioneve.

- **Air BP albania sh.a** është e vetmja shoqëri që operon në një treg mjaft specifik siç është ai blerjes së karburantit për avione. Jet A-1 Aviation Kerosene, është karburanti i vetëm, i cili përdoret me siguri të lartë të motorët e avioneve.

Përmbushja e kushteve për përjashtim

Përfitimet ekonomike do të favorizojnë jo vetëm palët e marrëveshjes, por gjithashtu edhe konsumatorët.

Marrëveshja kontribuon në përmirësimin e kushteve të furnizimit të tregut;

- Marrëveshja e njoftuar përmirëson mënyrën se si produkti shpërndahet në treg
- Aeroporti i Tiranës do të ketë depozita në territorin e tij dhe do të mund të monitorojë stoqet cilësinë e produktit dhe cilësinë e shërbimit duke u bazuar në standardet e tij.
- ABP si një nga shoqëritë më të mëdha ndërkombëtare në fushën e karburanteve është në gjendje të sigurojë produktin edhe në mënyra të tjera në rast mungese nga burimi aktual.

Sjell përfitime esenciale për konsumatorët

- ABP është një furnizues ndërkombëtar i mirënjohur në fushën e karburanteve për avionë dhe i pranishëm në mbi 1000 aeroporte në mbarë botën.
- ABP kujdeset që ti sigurojë operatorëve ajrorë një shërbim sa më të sigurtë, ekonomik dhe eficient

Efektet që do sjellë marrëveshja do ta bëjë ndërmarrjen shumë konkurruese në tregun ndërkombëtar

- Cilësia e shërbimeve që do të ofrohet do të rritet në mënyrë të ndjeshme në krahasim me situatën aktuale në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës sepse impiantet e reja, ndërtimin e të cilave e ka marrë ABP në baze të kësaj marrëveshje, do të përmbajnë standartet ndërkombëtare dhe zhvillimet më të fundit teknologjike.

Përfitime për tregun:

1. Sigurojnë që Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës të ketë në dispozicion karburant për avionë në shërbim të operatorëve ajror, për një kohë të gjatë dhe i ofruar nga një furnizues me “emer te mire” ndërkombëtar si ABP i cili ka akses në burime me çmim konkurrues të produktit dhe ka aftësinë të ofrojë një shërbim i cili zbaton rreptësisht standarde ndërkombëtare.
2. Bazuar në marrëveshjen e njoftuar, do të perdoret një teknologji e avancuar, që do të sjellë zhvillim në nivelin e sigurisë, cilësisë së produktit dhe kostove eficientë, do të aplikohet një siguracion prej 750 000 000 dollarësh², me qëllim mbulimin e plotë financiar të çdo përgjegjësie të mundshme.
3. Për konsumatorët, ku kërkesa vjetore e kalon 20% e furnizimit të përgjithshëm vjetor në Aeroport, është caktuar një çmim tavan 0.4& dollarë për çdo US Gallon mbi çmimin ndërkombëtar të kuotuar gjatë mesatares së ditëve të punës së gjysmë muajit të fundit në Plats Cargoes FOB me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve ndaj përpjekjeve arbitrare për të rritur çmimet në nivele të paarsyeshme.
4. Marrëveshja e njoftuar arrin gjithashtu të bëjë vendosjen e impiantit të depozitimit të karburantit nga një vendndodhje jashtë aeroportit tek një zonë e re brenda tij gjë që rrit sigurinë e veprimtarisë dhe redukton lëvizjet e tepërta dhe përmbush një nga detyrimet kryesore të TIA-s të përcaktuara në Marrëveshjen e Koncesionit.
5. Air BP si kompani me eksperience në mbi 90 aeroporte ndërkombëtare ka disa programe trajnimi të cilat në mënyrë të vazhdueshme kërkojnë të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e stafit punonjës në aeroport. Në këtë mënyrë konsumatorët në aeroport do të kenë cilësinë më të lartë të shërbimeve, ashtu siç janë të ofruara në aeroportet më kryesore të Europës.
6. Kjo marrëveshje, pavarësisht kufizimeve që sjell në tregun e shërbimit të furnizimit me karburant për avione në avione të justifikuar nga vete specifika e këtij shërbimi: kontribuon në përmirësimin e shpërndarjes së produktit dhe shërbimit, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, uljen e kostos së shërbimit dhe produktit, realizon një pjesëmarrje me të drejte në përfitim nga ana e konsumatorëve, nxit kërkimin dhe zhvillimin dhe përhapjen e njohurive profesionale, rrit sigurinë për sasinë e mallrave që ofron dhe realizon mbulimin e plote financiar të çdo përgjegjësie të mundshme:

¹ Referenca seksioni 6.5 i Marrëveshjes

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 6, pika 1, (germa a) dhe pika 2, dhe nenit 50 pika 1 e Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ;

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga ndalimi, (i parashikuar në nenin 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”), Marrëveshjen e datës 24.02.2009 midis “Tirana International Airport” Sh.p.k dhe “Air BP Albania” Sh.a, “Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Rezana Konomi

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

BULETINI ZYRTAR
NR.5, 2009